



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, nenit 6.2 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 i datës 27.12.2006 dhe nenit 19.1 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës i Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2015, miratoi:

### **VENDIM**

### **PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE**

#### **Neni 1**

z. Mustaf Abazit nga fshati Sallabajë, i lejohe ndërrimi i destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar në ngastrën kadastrale nr. 501-0 kultura – arë kl. 5 vendi i quajtur lligja- Ara te lligja në sipërfaqe prej 6529 m<sup>2</sup> Zona kadastrale Sallabajë , Certifikata nr. 08/714/55225/2015 të datës 05.06.2015.

#### **Neni 2**

Pronari obligohet që paluajtshmërinë përkatëse ta shfrytëzojë për ndërtimin e objektit – banjë rehabilituese.

#### **Neni 3**

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

#### **Neni 4**

Vendimin e zbatojnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

#### **Neni 5**

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-320-70756**  
**Podujevë,**  
**31 korrik 2015**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Mehtmet Gashi**